Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr/Br. 294/19
Datë/Datum 23.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 294/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata" me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/, më datë: 04.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata" me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/.

II. **VËRTETOHET,** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata" me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/, ndërsa nëse edhe me tutje AK-ja, ka interes për të vazhduar me ketë aktivitet të prokurimit të njëjtin mund ta ritenderoj konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 21.03.2019.
Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 07.05.2019
Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 16.04.2019.
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 19.04.2019.
Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 31.05.2019.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 03.06.2019

Operatori ekonomik ankues: "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.06.2019, me nr.294/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata" me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59.4 dhe 62, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 44.7 dhe 8 të RrUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 12.06.2019, ka autorizuar eksperten profesionale te prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit, në raportin e dt: 25.06.2019, sqaron pretendimet e OE ankues - "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, se AK ka anuluar pa te drejtë këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa si arsye e kanë dhëne se një shkelje të ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Ne si operatorë ekonomik dhe si palë me interes në këtë procedurë, nuk e dime arsyen e saktë se përse është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe se çfarë shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo

konsiderojmë se ne këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parashikuara të nenit 62 të LPP-së dhe në nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), prandaj vlerësojmë se ky aktivitet i prokurimit është anuluar pa bazë ligjore.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lëndës dhe në njoftimet e publikuara nga AK konstaton se me dt.29.05.2019, është publikuar ne platformën e e-prokurimit njoftimi për anulimin e këtij Aktivitetit të prokurimit ne lidhje me këtë vendim eksperti shqyrtues ka kërkuar një sqarim nga AK-ë, ku ka marr këtë përgjigjeje:

Citoj: Me dt 29.05.2019 kemi anuluar aktivitetin me arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi,
Ne njoftim për kontrate dhe dosje tenderit variantet nuk pranohen.
Sqarim
Ne dosjen e tenderit te specifikat teknike te detyrueshme ka qen kërkese nga njësia kërkuese departamenti I logjistikes.
1. Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C .
Pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës, para nënshkrimi te kontratës, kemi kontrolluar edhe një here lëndën dhe specifikat teknike, është konstatuar se nga fillimi njësia kërkuese departamenti I logjistikes -është lëshuar një gabim teknik nuk ka asnjë lloj klime ne bote :ultë -10 °C , siç është kërkuar ne D.T. (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).

Andaj, me date:13.05.2019, keni publikuar Njoftimi për anulimin e dhënies se kontratës, arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Është konstatuar se asnjëra nga ofertat nuk i plotësojnë kërkesën tek specifikat teknike te detyrueshme : Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në nenin 44.5 pika (ix) e RRUOPP-së ku thotë, Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te ofertave sqaron se asnjëri nga OE nuk kanë plotësuar kriterin e vendosur ne specifikimet teknike te detyrueshme ku ka qen (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).

OE I rekomanduar për kontratë tek katalogu me përshkrime ka sjell -7/+24
OE ankues ka sjell disa variante -7/+24, -15/+24,-22/+24
OE "As Tech" sh.p.k nuk e ka përshkrimin për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes ne katalogun e ofruar
OE Grupi i Operatoreve Ekonomik Ger Group SH.P.K ka ketë përshkrim -15°C≤T≤50°C

Prandaj duke u bazuar ne specifikimin teknik te detyrueshëm te vendosur ne dosjen e tenderit AK-ës gjatë përgatitjes e ofertës ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 duke vendosur një kriter te tillë ku kufizon konkurrencën e OE.

28.2 Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

AK edhe pas kërkesës se një OE për sqarime te dosjes se tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 i LPP-së
Kërkesa e OE Citoj : Te sqarimet është cekur: Klimat e reja duhet te janë me sistem te ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet te funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ulte-10°C. Ju lutem a mund te specifikoni nëse klimat e kërkuara ju duhen! Inverter apo te thjeshta (d.m.th.pa inverter) e qe edhe ato ngrohin varësisht nga prodhuesi deri kur temperaturat e jashtme janë -5 ose edhe -7°C
Prandaj AK duke mos e marr parasysh këtë kërkesë OE për sqarim vazhdon përsëri duke dhëne përgjigjeje se Klima duhet te ngrohë deri ne temperaturën -10 °C. Sipas specifikimit teknik.

Përsëri AK ka vazhduar me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës për OE "ENG HOUSE COMPANY" SH.P.K i cili ka sjell përshkrim sistemin e ngrohjes -7/+24 e jo siç ka qenë e kërkuar -10 0C, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 te LPP-së, dhe nenin 59 të LPP-së ku thotë:

7.1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

59 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Dhe pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës AK-ës ka marr vendim për Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit me arsyetimin se nje shkelje e ligjit ka ndodh. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është pa i bazuar sepse siç u sqarua edhe me larte OE ankues ka ofertuar me variante (-7/+24, -15/+24,-22/+24 variantet e oferuara nga OE ankues) dhe siç vërehet asnjëra nga variantet e oferuara nuk e plotëson kërkesën e AK qe Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).
Gjithashtu ekspertja profesionale sqaron se ne njoftimin për kontrate ne piken II.1.7) AK-ja, ka vendosur qe Variantet te mos pranohen.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), të mbetet ne fuqi Vendimi i Autoritetit kontraktues.

Operatori ekonomik "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, përmes parashtresës me shkrim të datës: 27.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/, përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Ne qëndrojmë ne tërësi pran pretendimeve ankimore te parashtruara ne ankesën e datës 10.06.2019, dhe konsiderojmë se ky AP është anuluar ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-së, dhe ne kundërshtim me nenin 44.7 dhe 8 te RrUOPP-së. Sepse ne ketë AP ne jemi kompania e përgjegjshme dhe i plotësojmë te gjitha kërkesat e FDT-së, dhe njoftimit për kontrate.
OE ENG HAUSE SHPK është i papërgjegjshëm për shkak qe nuk i ka plotësuar spec,teknike sipas DT-së për shkak se ka ofruar sistemin e ngrohjes te klimave te cilat mund te funksionojnë deri ne minus 7 grade celciues, ndërsa kërkese e DT-së ka qene deri ne minus 10 Grade Celcius. PO ashtu edhe OE tjetër AS Tech është i papërgjegjshëm për shkak qe nuk ka ofruar katalogje me përshkrimet e spec,teknike por i ka ofruar disa fotografi kopje, prandaj 39.8 te RrUOPP-së konsiderohet i papërgjegjshëm.
Ky AP është anuluar me arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund te rregullohet apo nuk mund te parandalohet përmes një ndryshimi, mirëpo ne nuk jemi ne dijeni se çfarë shkelje ka ndodhur apo do te ndodhe ne ketë rast dhe për ketë arsye kemi parashtruar ankese.
Sa i përket ekspertizës ne nuk pajtohemi me mendimin e E.SH. ne ketë rast për faktin se ne nuk kemi parashtruar asnjë pretendim për shkelje te nenit 28 te LPP-së, dhe ne ketë faze ku gjendet ky AP nuk parashihet ne asnjë dispozite ligjore se mund te anulohet një AP për mos respektim te nenit 28 te LPP-së. Gjithashtu nuk pajtohemi me konstatimet e E.SH. se ne si OE kemi ofertuar me varjante fillimisht nuk ka ekzistuar ndonjë arsye e eliminimit apo pretendim ankimore ne lidhje me këtë çështje edhe pse ne në oferte kemi bashkangjitur disa lloje te klimave qe punojnë ne temperatura te ndryshme e qe e tejkalojnë kërkesën e AK ku ka qen e parashikuar qe te punojnë deri ne minus 10 grade celsius. Konsiderojmë qe ne jemi ofertues te përgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Maqedonci deklaroj: Asnjë nga ofertat nuk e plotësojnë kriterin minus 10 grade, nuk është kërkuar as mbi e as nene fiks 10 grade, Panelit ia dorëzoj kopjen e katalogëve te cilat i ka prezantuar OE ANKUES se nuk e cek se cilën klime e oferton. Ne pyetjet sqaruese nga OE ka qene se a mund te jen minus 5-7 përgjigja e Autoritetit Kontraktues ka qen minus 10. Duke par se nuk ka minus 10 askund ne prodhim atëherë e kemi bere anulimin këtij AP.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja profesionale e prokurimit znj. Beka deklaroj: Vendimin e anulimit te këtij AP thuhet se një shkelje e ligjit ka ndodhur apo do te ndodhe dhe nuk mund te rregullohet apo te parandalohet përmes një ndryshimi, ne njoftim nuk ka pasur sqarim tjetër për anulim, prandaj kam kërkuar sqarim nga Autoriteti Kontraktues arsyet e anulimit. Ju kam dërguar një shkrese dhe me është përgjigjur se kane bere shkelje departamenti i logjistikes me vendosjen e këtij kriteri pasi nuk ka askund ne bote këso klime ku temperaturat e jashtme janë minus 10 qe te kenë edhe sistemin e ngrohjes, po ju dorëzoj panelit shkresën me e-mail e me kanë dërguar Autoriteti Kontraktues. Sa i përket OE ankues se nuk ofertuar me variante ne Ofertën e tij ka sjelle 3 lloje te klimave ku e para ka sistemin e ftohjes dhe ngrohjes minus 7 dhe plus 24 e dyta minus 15 dhe plus 24 dhe e treta minus 22 dhe plus 24. Dhe nuk ka te nënvizuar se cilën klime ka për ta ofertuar. Ne DT ka qene qe variantet nuk lejohen. Qëndroj prapa mendimit të dhënë ne ekspertize.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së, z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë qe te aprovohet ankesa e jone si e bazuar te anulohet vendimi dhe njoftimi i Autoriteti Kontraktues për anulimin e këtij AP dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së, z. Maqedonci deklaroj: Propozojmë qe te hudhet poshtë ankesa e OE si e pabazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan, pretendon se autoriteti kontraktues KGJK, ka anuluar pa te drejtë aktivitetin e prokurimit, ndërsa si arsye e kanë dhëne se një shkelje të ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.
Andaj ne si operatorë ekonomik pjesëmarrës dhe si palë me interes në këtë procedurë, nuk e dimë arsyen e saktë se përse është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe se çfarë shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo

konsiderojmë se ne këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parashikuara të nenit 62 të LPP-së, dhe në nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), prandaj OE ankues pretendon se ky aktivitet i prokurimit është anuluar pa bazë ligjore.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në dokumentacionin në lëndës dhe në njoftimet e publikuara nga AK konstaton se me dt.29.05.2019, është publikuar ne platformën e e-prokurimit njoftimi për anulimin e këtij Aktivitetit të prokurimit ne lidhje me këtë vendim ekspertja ka kërkuar një sqarim nga AK-ë, ku ka marr këtë përgjigjeje si në vijim :
Me dt 29.05.2019, kemi anuluar aktivitetin me arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi, Ne njoftim për kontrate dhe dosje tenderit variantet nuk pranohen.
Sqarim
Ne dosjen e tenderit te specifikat teknike te detyrueshme ka qen kërkese nga njësia kërkuese departamenti i logjistikes.
1. Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C .
Pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës, para nënshkrimi te kontratës, kemi kontrolluar edhe një here lëndën dhe specifikat teknike, është konstatuar se nga fillimi njësia kërkuese departamenti I logjistikes -është lëshuar një gabim teknik nuk ka asnjë lloj klime ne bote :ultë -10 °C , siç është kërkuar ne D.T. (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).
Andaj, me date:13.05.2019, keni publikuar Njoftimi për anulimin e dhënies se kontratës, arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Është konstatuar se asnjëra nga ofertat nuk i plotësojnë kërkesën tek specifikat teknike te detyrueshme : Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se duke u bazuar në nenin 44.5 pika (ix) e RRUOPP-së, ku thuhet: *Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:*
(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit duke u bazuar ne rrjedhën e kësaj procedure konstaton se asnjëri nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet te prokurimit nuk kanë plotësuar kriterin e vendosur ne specifikimet teknike te detyrueshme ku ka qen (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C). Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë tek katalogu me përshkrime ka sjell -7/+24, OE ankues ka sjell disa variante -7/+24, -15/+24,-22/+24. Ndërsa OE "As Tech" sh.p.k nuk e ka përshkrimin për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes ne katalogun e ofruar, dhe Grupi i Operatoreve Ekonomik Ger Group SH.P.K ka ketë përshkrim -15°C≤T≤50°C.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit konstaton se duke u bazuar ne specifikimin teknik të detyrueshëm te vendosur ne dosjen e tenderit autoriteti kontraktues KGJK, gjatë përgatitjes e ofertës ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 të LPP-së, duke vendosur një kriter te tillë ku kufizon konkurrencën e OE.

28.2 Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se autoriteti kontraktues KGJK, edhe pas kërkesës se një operatori ekonomik për sqarime te dosjes se tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 i LPP-së. Ku kërkesa e OE-së ka qen : Te sqarimet është cekur: Klimat e reja duhet te janë me sistem te ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet te funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ulte-10°C. Ju lutem a mund te specifikoni nëse klimat e kërkuara ju duhen! Inverter apo te thjeshta (d.m.th.pa inverter) e qe edhe ato ngrohin varësisht nga prodhuesi deri kur temperaturat e jashtme janë -5 ose edhe -7°C.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se AK duke mos e marr parasysh këtë kërkesë të operatorit ekonomik për sqarim vazhdon përsëri duke dhëne përgjigjeje se Klima duhet te ngrohë deri ne temperaturën -10 °C. Sipas specifikimit teknik.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron, se përsëri autoriteti kontraktues KGJK, ka vazhduar me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës për OE "ENG HOUSE

COMPANY" SH.P.K i cili ka sjell përshkrim sistemin e ngrohjes -7/+24 e jo siç ka qenë e kërkuar -10 0C, duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 te LPP-së, dhe nenin 59 të LPP-në të cilin thuhet:

7.1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

59 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Dhe pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës autoriteti kontraktues KGJK, ka marr vendim për Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit me arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodh.

Paneli shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit duke u bazuar në këto fakte konstaton se pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar për faktin se OE ankues -"Alfa.i" sh.p.k – Lipjan, ka ofertuar me variante (-7/+24, -15/+24,-22/+24 variantet e oferuara nga OE ankues), dhe siç vërehet asnjëra nga variantet e oferuara nuk e plotëson kërkesën e autoriteti kontraktues KGJK, qe sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C). Andaj autoriteti kontraktues ne njoftimin për kontrate ne piken II.1.7) ka vendosur qe Variantet te mos pranohen.

Paneli shqyrtues duke u nisur nga të dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit te prokurimit në fjalë është bëre në harmoni me nenin 62 të LPP-së, dhe 44.7 te RrUOPP, për faktin se oferta e operatorit ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesën e autoriteti kontraktues KGJK, qe sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C), kërkesë kjo tek specifikat teknike të detyrueshme, gjithashtu edhe ofertat e operatorve ekonomik pjesëmarrës ne ketë aktivitet te prokurimit nuk plotësoj ketë kërkesë të AK-së, pasi qe kanë ofertuar me variante dhe AK ne njoftimin për kontrate ne piken II.1.7), ka vendosur qe Variantet te mos pranohen. Andaj, autoritetet

kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës /KGJK/

1x1 OE -"Alfa.i" sh.p.k –Lipjan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.